DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO PRIVATIZATION AGENCY RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU

AC-I-13-0037

Ankuesit në shkallë të parë:

Në padinë e

C1. R.B,
C2. M.K,
C3. Z.D,
C4. M.G,
C5. S.K,
C7. S.S,

Kundër

E paditura/ankuesja në shkallë të dytë

Agjencia Kosovare e Privatizimit
rr. "Ilir Konushevci" nr. 8 Prishtinë/

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej DHPGJS) i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, si Gjyqtar Kryesues, Vladimir Kanev, Sabri Halili, Ondrej Pridal dhe Diellza Hoxha, Gjyqtarë, duke vendosur për ankesën e paditësve të parashtruar kundër Aktgjykim të Kolegjit të Specializuar, SCEL-11-0015, të datës 26 shkurt 2013, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 18 nëntor 2016, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. **Ankesa e AKP-së është e pabazuar.**
2. **Vërtetohet Aktgjykim i Kolegjit të Specializuar, SCEL-11-0015, i datës 26 shkurt 2013.**
3. **Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

<u>Rrethanat faktike dhe procedurale:</u>

Ankuesit janë ish-punëtorë të NSH-së "K" (më tej: NSH) e cila është privatizuar nga e paditura.

Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime është shpallur me 2 prill 2011 dhe afati i fundit për paraqitjen e ankesave në DHPGJS kundër listës përfundimtare ishte më 23 prill 2011.

Më 8 prill 2011, R.B. (**ankuesi C1**) ka paraqitur ankesë në DHPGJS kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve. Ankuesi ka punuar në NSH prej datës 9 maj 1977 deri në qershor të vitit 1999. Ai thekson se është penguar fizikisht që të shkojë në punë dhe se është dashur të largohet nga Prishtina nga frika për jetën e tij dhe të familjes. Ai ankohet se e vetmja arsye pse emri i tij nuk është përfshirë në listën e punëtorëve është diskriminimi mbi bazën e përkatësisë së tij etnike serbe. Ai e ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës.

Në përgjigjen me shkrim të datës 26 prill 2011, AKP-ja i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë ankesën si të pabazuar sepse libreza e punës e dorëzuar ishte mbyllur më 17 gusht 1999, se ai nuk kishte dorëzuar asnjë provë për vazhdimin e punësimit të tij pas vitit 1999 dhe se ai nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim ligjor lidhur me vazhdimin e punësimin e tij pas vitit 1999. Për më tepër, ankuesi nuk ka dëshmuar me prova ligjore se i kishte kontaktuar autoritet kompetente të sigurisë në Kosovë, KFOR-in apo UNMIK-un, dhe nuk ka qenë i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit të saj.

Më 15 prill 2011, M.K. (**ankuesi C2**) ka paraqitur ankesë në DHPGJS kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve. Ankuesi ka punuar në NSH prej datës 19 qershor 1984 deri në qershor të vitit 1999. Ai thekson se është penguar fizikisht që të shkojë në punë dhe se është dashur të largohet nga Prishtina nga frika për jetën e tij dhe të familjes. Ai ankohet se e vetmja arsye pse emri i tij nuk është përfshirë në listën e punëtorëve është diskriminimi mbi bazën e përkatësisë së tij etnike serbe. Ai e ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës.

Në përgjigjen me shkrim të datës 5 maj 2011, AKP-ja i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë ankesën si të pabazuar sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për përfshirjen e tij në listën e punëtorëve dhe se libreza e tij e punës ishte mbyllur në vitin 1999. Ai nuk kishte qenë i punësuar në NSH në kohën e privatizimit, dhe kishte filluar një marrëdhënie të re pune me një punëdhënës tjetër. Pastaj, ai nuk ka dorëzuar asnjë provë për vërtetimin e punësimit të tij pas vitit 1999, dhe se ishte diskriminuar në bazë të etnisë dhe se nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit. Andaj, AKP-ja propozon që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Më 15 prill 2011,Z.D. (**ankuesi C3**) ka paraqitur ankesë në DHPGJS kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve. Ankuesi ka punuar në NSH prej datës 15 qershor 1987 deri në qershor të vitit 1999. Ai thekson se është penguar fizikisht që të shkojë në punë dhe se është dashur të largohet nga Prishtina nga frika për jetën e tij dhe të familjes. Ai ankohet se e vetmja arsye pse emri i tij nuk është përfshirë në listën e punëtorëve është diskriminimi mbi bazën e përkatësisë së tij etnike serbe. Ai e ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës dhe një kopje të vërtetuar të vendimit për pushim vjetor nr.567të datës 16 qershor 1998.

Në përgjigjen me shkrim të datës 5 maj 2011, AKP-ja i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë ankesën si të pabazuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë kundër listës së përkohshme në pajtim me nenin 67.2 të Urdhëresës Administrative 2008/6. Në bazë të nenit 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, palët mund t'i

drejtohen gjykatës vetëm pasi të janë shterur të gjitha mjetet administrative të ankesës. Andaj, AKP-ja propozon që ankesa e Z. D., të refuzohet si e pabazuar.

Më 15 prill 2011, M.G. (**ankuesja C4**) ka paraqitur ankesë në DHPGJS kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve. Ankuesja ka punuar në NSH prej datës 1 shtator 1990 deri në qershor të vitit 1999. Ajo thekson se është penguar fizikisht që të shkojë në punë dhe se është dashur të largohet nga Prishtina nga frika për jetën e saj dhe të familjes. Ajo ankohet se e vetmja arsye pse emri i saj nuk është përfshirë në listën e punëtorëve është diskriminimi mbi bazën e përkatësisë së saj etnike serbe. Ajo e ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së saj të punës.

Në përgjigjen me shkrim të datës 25 maj 2011, AKP-ja i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë ankesën si të pabazuar sepse ankuesja nuk ka parashtruar ankesë kundër listës së përkohshme në pajtim me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative.

Më 19 prill 2011, S.K. (**ankuesi C5**) ka paraqitur ankesë në DHPGJS kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve. Ankuesi ka cekur se përvoja e tij e punës është afërsisht 22 vite, se ka jetuar në Mitrovicë, në pjesën veriore, se nuk ka mundur të shkojë në punë rregullisht por vetëm kohë pas kohe, deri në maj të vitit 2002. Ai nuk e posedon librezën e tij të punës, por e ka vetëm një kopje të faqes së parë sepse nuk e din se ku gjendet ajo. Ai ka thënë se drejtori M.B. gjithnjë e ka shtyrë atë që të largohet nga kompania për shkak të etnisë së tij. Ai e ka dorëzuar një vërtetim të lëshuar nga NSH-ja,të datës 14 shkurt 2002, një kopje të faqes së parë të librezës së tij të punës, vendimin nr. 2 të datës 31 janar 2002 të lëshuar nga NSH-ja , vendimin nr. 221 të datës 16 shtator 1999 të lëshuar nga NSH-ja.

Në përgjigjen me shkrim të datës 18 maj 2011, AKP-ja i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë ankesën si të pabazuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme në pajtim me nenin 67.2 të Urdhëresës Administrative 2008/6, në bazë të nenit 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative.

Më 22 prill 2011,S.S. (**ankuesja C7**) ka paraqitur ankesë në DHPGJS kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve. Ankuesja ka punuar në NSH prej datës 21 gusht 1986 deri në qershor të vitit 1999. Ajo thekson se është penguar fizikisht që të shkojë në punë dhe se është dashur të largohet nga Prishtina nga frika për jetën e saj dhe të familjes. Ajo ankohet se e vetmja arsye pse emri i saj nuk është përfshirë në listën e punëtorëve është diskriminimi mbi bazën e përkatësisë së saj etnike serbe. Ajo e ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së saj të punës.

Në përgjigjen me shkrim të datës 25 maj 2011, AKP-ja i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë ankesën si të pabazuar sepse ankuesja përveç librezës së punës nuk ka dorëzuar ndonjë provë tjetër në bazë te të cilave do të vihej në përfundim vazhdimësia e punësimit të saj në NSH pas vitit 1999. Ankuesja thekson se është diskriminuar, mirëpo, nuk e ka dëshmuar këtë me ndonjë provë materiale sepse nuk ka prova se ajo i ka kontaktuar forcat e sigurisë në Kosovë, KFOR-it dhe Policinë e UNMIK-ut. Për më tepër, ankuesja nuk ka qenë e regjistruar si punëtore e NSH-së në kohën e privatizimit.

Më 26 shkurt 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ka lëshuar aktgjykimin dhe në pikën e dytë të dispozitivit vendosi që t'ua pranojë ankesat e të gjashtë të padituve në ankesë.

Kolegji i Specializuar lidhur me pikën e dytë të dispozitivit arsyetoi se ankesa e ankuesve janë të bazuara, edhe pse ata nuk ishin të punësuar në NSH në kohën e privatizimit. Ankuesit e kishin lënë NSH-në në qershor të vitit 1999 ose pas qershorit të vitit 1999 sepse nuk ndiheshin të sigurt. Asnjëri prej tyre nuk kishte dorëzuar dokumente për të dëshmuar se në fakt ishin sulmuar apo diskriminuar. Asnjëri prej tyre nuk pohoi në detaje për ndonjë akt agresioni apo diskriminimi. Megjithatë, edhe e paditura as nuk e kundërshtoi se ata u larguan nga vendi për shkak të frikës, e as nuk e kontestoi se frika e tillë pas përfundimit të luftës ishte e arsyeshme për serbët.

Kolegji i Specializuar theksoi se edhe nëse të padituri do ta kontestonin pretendimin nuk do të ishte barrë e ankuesve për ta dëshmuar diskriminimin por e kundërta.

Më 26 mars 2013, AKP-ja parashtroi ankesë lidhur me pikën e dytë të dispozitivit ku 6 ankues ishin përfshirë në listën e punëtorëve me të dejtë për 20% dhe kërkoi që paditë të hedhen poshtë si të papranueshme. AKP-ja pretendoi shkeljen esenciale të nenit 182 paragrafi 2 (n) të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore sepse dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin. Pala ankuese gjithashtu nuk pajtohet me konstatimin e Kolegjit të Specializuar lidhur me ekzistimin e diskriminimit.

Më 15 prill 2013, DHPGJS-ja lëshoi një urdhër me të cilin e dërgoi ankesën e AKP-së tek paditësit.Më 28 tetor 2013, gjyqtari raportues urdhëroi që urdhri të dërgohet bashkë me ankesë përmes postës së rregullt.

Më 14 nëntor 2013,paditësi R. B. (C1) dhe më 22 nëntor 2013 paditësi M. K.(C2) parashtruan përgjigjet ndaj ankesës së AKP-së me argumente të njëjta.

<u>Arsyetimi ligjor</u>

Kolegji i Apelit vendosi që të mos e mbajë pjesën gojore të procedurës gjyqësore, në bazë të nenit 64 paragrafi 1 të shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ankesa është e pabazuar. Kolegji i Apelit nuk ka konstatuar ndonjë mospërputhje në mes të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar dhe arsyetimit të tij. Përkundrazi, aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar është i arsyetuar mirë dhe në pajtim me praktikën e krijuar të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme për këso lloj rastesh. Kolegji i Apelit në një radhë lëndësh ka konstatuar se:

- është një fakt i ditur se pas ardhjes së forcave ndërkombëtare në qershor të vitit 1999 gjendja e sigurisë për serbët e Kosovës u keqësua shumë shpejt dhe në masë të madhe në rajonet në jug të lumit Ibër;
- mungesa e sigurisë personale ka të njëjtin efekt ligjor sikurse diskriminimi mbi baza të përkatësie etnike;
- serbët të cilët ikën nga Kosova (pjesa jugore e lumit Ibër) pas qershorit të vitit 1999 dhe të trajnohen si të diskriminuar në të gjitha kuptimet materiale dhe procedurale.

Përveç kësaj dhe që nga vitit 2012 të gjitha kolegjet e specializuara të Dhomës së Posaçme kanë adaptuar interpretimin se ankesa kundër listës së përkohshme të punëtorëve përfitues nuk është kusht për parashtrimin e ankesës kundër listës përfundimtare.

Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar është i saktë dhe duhet të vërtetohet.

Taksat gjyqësore

Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë sepse plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së, i cili ka hyrë në fuqi më 27 mars 2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive për lëndët në pritje.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 nëntor 2016.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues